

**SUPREME COURT OF KOSOVO  
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS  
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL  
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së  
ŽALBENO VEĆE KAI**

**GSK-KPA-A-087/2015**

**Prishtinë,  
22 mars 2017**

Në çështjen juridike të

**Z.Đ.**

**Pala ankuese**

kundër

**N /A**

**Pala përgjegjëse në ankesë**

Kolegji i Apelit të AKP-së të Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga Sylejman Nuredini, Kryetar i Kolegjit, Krassimir Mazgalov dhe Beshir Islami, gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës, KPCC/D/C/255/2014 (të datës 27 gusht 2014 (lënda e regjistruar në AKP me numrin KPA13367), pas shqyrtimit të mbajtur me 22 mars 2017, mori këtë:

## **AKTGJYKIM**

- 1. Refuzohet si e pabazuar ankesa e Z. Đ. kundër Vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/C/255/2014 sa i përket lëndës së regjistruar në AKP me numrin KPA13367.**
- 2. Vërtetohet Vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/C/255/2014, sa i përket lëndës së regjistruar në AKP me numrin KPA13367.**

### **Përmbledhje e çështjeve procedurale dhe faktike**

1. Më 5 shtator 2009, Z. Đ.(në tekstin e mëtutjeshëm: pala ankuese) ka paraqitur kërkesë në emër të babait të tij të ndjerë, T. Đ, në Agjencinë Kosovare të Pronës (në tekstin e mëtutjeshëm: AKP) duke kërkuar ri-posedimin e dy (2) shtëpive me sipërfaqe prej 50 m<sup>2</sup> dhe 100 m<sup>2</sup> dhe të tokës në të cilën ishin vendosur shtëpitë e cila, sipas palës ankuese përmban sipërfaqen prej 00.12.00ha dhe ndodhet në vendin e quajtur Kripimeh, Komuna e Podujevës (në tekstin e mëtutjeshëm: prona e kërkuar). Pala Ankuese nuk dha asnjë detal tjetër në lidhje me pronën e kërkuar duke mos përmendur as numrin e ngastrës kadastrale.
2. Pala ankuese ka deklaruar se babai i tij e kishte blerë pronën e kërkuar ndërsa humbja e posedimit kishte ndodhur si rezultat i rrethanave që kishin ndodhur në Kosovë në vitin 1998/1999.
3. Për ta mbështetur kërkesën e tij, ai i dorëzoi AKP-së dokumentet në vijim:
  - Kontratën e shitblerjes të lidhur më 30 mars 1961 në mes të V. Š. si shitës dhe T. Đ. dhe K. L., të dy si blerës. Objekt i shitjes ishte toka në të cilën gjendej një shtëpi dhe një hangar. Kontrata nuk specifikon as ngastrën kadastrale në të cilën prona e kërkuar gjendet e as sipërfaqen e tokës që ishte objekt i shitjes,
  - Dëftesën e datës 30 mars 1961 që tregon se shitësi e ka pranuar shumën prej 350.000 dinarëve (valutë jugosllave) nga T. Đ. dhe K. L. në emër të çmimit të shitblerjes,
  - Kontratën e shitblerjes nr. 2148 e lidhur më 31 dhjetor 1965 në mes të "Kooperativës Bujqësore Kripimeh", si shitëse dhe T. Đ.si blerës. Në kontratë është e specifikuar vetëm sipërfaqja prej 00.05.59 ha,

- Dëftesa nr. 1308, e datës 31 dhjetor 1965 që dëshmon se babai i palës ankuese kishte paguar shumën prej 8.500 dinarëve (valutë jugosllave), por nga dëftesa nuk mund të përcaktohet se për çfarë është paguar një shumë e tillë.
  - Certifikata e vdekjes nr. 203-58/06-08-4231 e lëshuar nga Zyra e Regjistrimit Civil, Komuna e Podujevës, më 26 korrik 2005, që dëshmon se T. Đ. ka ndërruar jetë më 31 maj 1996.
  - Deklarata e dëshmitarëve nr. 8990/09 e vërtetuar në Gjykatën e Parë Komunale në Beograd më 9 korrik 2009, ku, B. O. dhe M. R. kanë dëshmuar se T. dhe T. Đ. janë i njëjti person.
4. Identifikimi i kërkesës ishte bërë më 20 janar 2008. Sipas raportit të identifikimit, prona e kërkuar është gjetur të jetë një shtëpi e okupuar nga M. G. i cili nuk ka pretenduar asnjë të drejtë mbi pronën.
- Pasi që nuk ka asnjë ngastër kadastrale e cila ishte përcaktuar nga pala ankuese ose ndonjë informacion tjetër lidhur me tokën në të cilën gjendet shtëpia e pretenduar, raporti i identifikimit të pronës së kërkuar mund të mos jetë i saktë.
- Kërkesa u konsiderua e pakontestueshme nga Sekretaria Ekzekutive e AKP-së për shkak se asnjë palë nuk ka paraqitur përgjigje brenda afatit ligjor prej 30 ditësh, në pajtim me nenin 10.2 të Ligjit nr. 03/L-079.
5. Sekretaria Ekzekutive e AKP-së, pavarësisht përpjekjeve të saj, nuk ka gjetur asnjë provë të paraqitur nga pala ankuese. Sipas raportit të verifikimit të datës 31 tetor 2013, në Zyrën Kadastrale Komunale të Podujevës nuk ekziston asnjë pronë e regjistruar në emrin e babait të palës ankuese.
6. Pala Ankuese ishte kontaktuar dhe udhëzuar që të paraqesë dokumente shtesë përmes të cilave ai do të dëshmonte të drejtat që ai është duke i kërkuar. Si një përpjekje shtesë, Sekretaria Ekzekutive e AKP-së njoftoi palën ankuese përmes shkresës zyrtare se kërkesa e tij mund të refuzohej nëse ai nuk paraqet dokumente shtesë për të mbështetur pretendimet e tij ndaj pronës së kërkuar. Shkresa ishte pranuar nga pala ankuese më 14 tetor 2013 (faqe nr. 154 nga dosja e lëndës). Pala ankuese nuk iu është përgjigjur Sekretarisë Ekzekutive të AKP-së.
7. Më 27 gusht 2014, KKPK-ja me vendimin e tij KKPK/D/R/255/2014 refuzoi kërkesën e palës ankuese me arsyetimin se ai ka dështuar që të dëshmojë pronësinë ose ndonjë të drejtë tjetër pronësore mbi pronën e kërkuar menjëherë para ose gjatë konfliktit 1998-1999.
8. Pala ankuese e pranoi Vendimin më 28 tetor 2014 ndërsa ajo ushtroi ankesë më 26 nëntor 2014.

### **Pretendimet e palës ankuese**

9. Pala ankuese e kundërshton Vendimin e KKPK-së duke pohuar se vendimi është i bazuar në vërtetim të gabuar dhe të mangët të gjendjes faktike dhe shkelje thelbësore të së drejtës materiale dhe procedurale.
10. Pala ankuese pretendon se familja e tij e kishte fituar pronën e kërkuar në bazë të dy (2) Kontratave për shitblerje të cilat ishin lidhur në mes të Kooperativës Bujqësore Krpimej dhe babait të tij të ndjerë dhe një kontrate tjetër për shitblerje e lidhur në mes të babait të tij, K.L.si blerës dhe V. Š.si shitës i shtëpisë. Çmimi i blerjes ishte paguar dhe dëftesat ishin dorëzuar me kërkesë, por në bazë të palës ankuese nuk është kryer transferimi i të drejtës së paluajtshme në emër të babait të tij.
11. Pala ankuese ka deklaruar se familja e tij e kishte në posedim pronën e kërkuar deri në vitin 1999, kur për shkak të rrethanave të përgjithshme është dashur që të largohen nga Kosova, pra, fakti se ankuesi ka dështuar që të dëshmojë të drejtën pronësore ose të shfrytëzimit mbi pronën e kërkuar nuk është e vërtetë.
12. Bazuar në atë që u tha më lart, pala ankuese kërkon nga Gjykata Supreme që të pranojë ankesën e tij si të bazuar dhe që të vërtetojë të drejtën e ri-posedimit mbi pronat e kërkuara në favor të palës ankuese.
13. Në ankesë ishte bashkangjitur Ekstrakti i Fletës Poseduese nr. 64 i lëshuar nga Kadastrri i zhvendosur në Krushevc më 18 nëntor 2014 në të cilën janë të regjistruara të dy (2) ngastrat kadastrale në emër të V. Đ. (gjyshi i ankuesit).

### **Arsyetimi ligjor**

#### **Pranueshmëria e ankesës**

14. Ankesa është e pranueshme sepse është ushtruar brenda 30 ditëve siç parashihet me nenin 12.1 të Ligjit nr. 03/L-079.

#### **Meritat e ankesës**

15. Gjykata Supreme e shqyrtoi vendimin ankimor në përputhje me nenin 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore nr. 03/L-006 (në tekstin e më tutjeshëm: LPK) dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të pretendimeve të palës ankuese konstaton se ankesa është e pabazuar.

16. Gjykata Supreme konstaton se KKPK-ja ka nxjerrë vendim të drejtë kur ka refuzuar kërkesën.
17. Në përputhje me nenin 3.1 të Ligjit nr.03/L-079, paraqitësi i kërkesës ka të drejtë në një urdhër nga Komisioni për ri-posedimin e pronës nëse paraqitësi i kërkesës 'dëshmon' jo vetëm të drejtën e pronësisë mbi pronën e paluajtshme private, duke përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale , por edhe se ai apo jo nuk është në gjendje t'i ushtrojë ato të drejta pronësore për shkak të rrethanave që ndërlidhen drejtpërdrejtë apo burojnë nga konflikti i armatosur që ndodhi në Kosovë në periudhën ndërmjet 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999.
18. Në bazë të kësaj dispozite ligjore, pala ankuese duhet të paraqes prova për të dëshmuar të drejtën pronësore apo të drejtën për të shfrytëzuar pronën e paluajtshme.
19. KKPK-ja e bazon vendimin e saj në faktin se pala ankuese nuk ka arritur që të sigurojë ndonjë provë që mund të vërtetohet nga AKP-ja, se babai i tij si bartës i së drejtës pronësore gëzon ndonjë të drejtë pronësore mbi pronën, si dhe në faktin se Sekretaria Ekzekutive *ex officio* nuk ka siguruar prova të tilla.
20. Kontrata e shitblerjes e datës 30 mars 1961, si dhe Kontrata e shitblerjes e datës 31 dhjetor 1965 nuk u legalizuan në Gjykatën kompetente, prandaj, ato janë absolutisht pa efekt juridik.
21. Vetë pala ankuese ka deklaruar se kurrë nuk është bërë transferimi i të drejtës pronësore në emër të babait të tij.
22. Ankesa e palës ankuese rikthen të njëjtat pretendime që ajo i ka deklaruar para KKPK-së. Në ankesë nuk është ofruar asnjë provë e re.
23. Duke marrë parasysh atë që u tha më lart, Gjykata Supreme konstaton se KKPK-ja ka marrë një vendim të drejtë dhe të bazuar në rrjedhën e procedurës së duhur. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se nuk ka pasur asnjë shkelje të të drejtave materiale ose vërtetim të mangët të gjendjes faktike.
24. Sa i përket provave të reja të dorëzuara , ato nuk janë marrë parasysh nga gjykata. Kjo është në përputhje me nenin 12.11 të Ligjit 03/L-079 i cili ofron që:  
*Faktet e reja dhe dëshmitë materiale të paraqitura nga cilado palë lidhur me ankesën nuk pranohen dhe nuk shqyrtohen nga Gjykata Supreme përpos nëse tregohet se faktet dhe dëshmitë e tilla me arsye nuk kanë mundur të jenë të njohura për palën në fjalë.*
25. Në bazë të lartcekurave dhe në përputhje me nenin 13.3 nën (c) të Ligjit nr. 03/L-079, është vendosur sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

### **Këshillë ligjore**

Në përputhje me nenin 13.6 të Ligjit 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të zakonshme apo të jashtëzakonshme juridike.

**Sylejman Nuredini, Kryetar i Kolegjit**

**Krassimir Mazgalov, Gjyqtar i EULEX-it**

**Beshir Islami, Gjyqtar i EULEX-it**

**Sandra Gudaityte, Referente e EULEX-it**